



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 17.06.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 14.06.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "AOME&Tini" për aktivitetin: "Furnizimi me dru" dhe me numër të prokurimit: 616-19-2765-121 nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekono**"Aome&Tini"** e datës 14.06.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me dru" me Nr.616 19 2765 121, kundër *Njoftimit për anulim të aktivitetit*, të datës 13.06.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet Njoftimi për anulim të aktivitetit** i publikuar me datë: 13.06.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj respektimin e Vendimit për anulim të aktivitetit*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik **"Aome&Tini"** me datë 14.06.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me dru" me Nr.616 19 2765 121.

Autoriteti Kontraktues, me datë 17.06.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë plotësisht të pa bazuara për arsyet në vijim:
-Pretendimi se çmimi i tij është çmim real i tregut nuk qendron pasi që Agjencioni i Statistikave të Kosovës është institucion zyrtar që publikon çmimet mujore dhe të njejtat merren nga tregu

duke përfshirë të gjitha shpenzimet, pra edhe transportin. Në këtë çmim mund të mos jete përfshirë sharritja, por kjo nuk mund ta shtoj çmimin për 7.00 euro për m³.

Ua përkujtojmë se detyra kryesore e zyrtarit të prokurimit është që asnjë kontratë të mos lidhet në kundërshtim me çmimet e tregut dhe për këtë arsye është bërë anulimi. Një veprim i tillë është bërë edhe vitin e kaluar edhe pse vitin e kaluar tenderi juaj nuk ka qenë me çmimin me të ulët, por ka qenë tenderi i një OE-ik tjetër.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet nga Vendimi për anulim ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit